

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	23.07.2025 – 20.08.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	23/12/2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 06.10.2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 – MF- Nr. 2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Amela Kora Amela.Kora@financa.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Nisma e propozuar synon përcaktimin e rregullave dhe normave për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet në Republikën e Shqipërisë, me qëllim mbulimin e humbjeve financiare të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të shkaktuara në pasurinë e siguar, si pasojë e ngjarjeve të tërmetit.

Kjo nismë ligjore propozohet nisur nga fakti, se Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore. Katër rreziqet kryesore që prekin vendin tonë janë: tërmetet, përmytjet, zjarret dhe rrëshqitjet e dheut. Raporti i Rrezikut Botëror 2021, i cili llogarit Indeks të Rrezikut të Fatkeqësive për 181 vende bazuar në kapacitetet përbaluese, e rendit Shqipërinë të parën në Evropë dhe në vend të 61 në rang botëror.

Duke filluar nga viti 1900, Shqipëria është goditur nga dymbëdhjetë tërmete me magnitudë mbi 6 ballë. Në nëntor 2019, një tërmet shkatërrues me magnitudë 6.4 ballë goditi Shqipërinë duke prekur mbi 200,000 njerëz në 11 bashki dhe duke shkaktuar një ndikim të konsiderueshëm ekonomik të vlerësuar në 7.5 për qind të produktit të brendshëm bruto. Pjesa më e madhe e dëmit u përqendrua

në banesat rezidenciale me 18% të totalit të njërive të banimit të prekura. Pas tërmetit të vitit 2019, qeveria duhet të ndërhynte dhe të siguronte fonde për rindërtimin e pronave të shkatërruara të banimit.

Në përballje me pasojat e këtij tërmeti, qeveria shqiptare ndërmori masa të menjëhershme për të siguruar fonde emergjente, të cilat u përdorën për rindërtimin e banesave të dëmtuara dhe për mbështetjen e familjeve të prekura. Kjo situatë evidentoi ngarkesën financiare që fatkeqësitë natyrore shkaktojnë dhe nevojën për një model të qëndrueshëm dhe sistematik për menaxhimin e riskut dhe mbrojtjen sociale.

Rreziqet natyrore dhe gjeografike

Shqipëria ka një ekspozim të natyrshëm të lartë ndaj fatkeqësive, i cili nuk mund të eliminohet por vetëm të menaxhohet:

1. Tërmetet

- Ndodhin shpesh për shkak të pozicionimit gjeologjik të vendit.
- 12 tërmete me magnitudë mbi 6 ballë që nga viti 1900.
- Ngjarja e vitit 2019 tregoi potencialin e lartë shkatërrues nga tërmetet.

Referuar sa më sipër, në legjislacionin shqiptar nuk ekziston një ligj që të rregullojë skemën e sigurimit të detyrueshëm për banesat nga fatkeqësitë natyrore. Kjo mungesë përbën një problem sistematik me pasojat të gjera sociale, ekonomike, fiskale dhe institucionale. Vendit i mungon një mekanizëm kombëtar i menaxhimit financiar të riskut, i cili është i domosdoshëm për një shtet me ekspozim të lartë ndaj rreziqeve natyrore.

Mungesa e një ligji që e bën sigurimin të detyrueshëm, lë shumicën e familjeve të ekspozuara financiarisht.

- Vetëm një pjesë shumë e vogël e banesave në Shqipëri është aktualisht e siguruar në mënyrë vullnetare.
- Familjet me të ardhura të ulëta, të mesme dhe veçanërisht ato në zonat më të rrezikuara, shpesh nuk kanë mundësi ekonomike të sigurojnë vetë pronën.

Ky fakt shton pasigurinë sociale, cenon mirëqenien e familjeve dhe e bën rimëkëmbjen individuale shumë të ngadaltë.

Në mungesë të një skeme të detyrueshme sigurimi, çdo ngjarje e madhe natyrore shkakton:

- presion të menjëhershëm fiskal mbi qeverinë;
- nevojë për mobilizim të fondeve për rindërtim;
- rishpërndarje të buxhetit publik me ndikim ndaj prioriteteve të tjera (shëndetësi, arsim, investime publike).

Shembulli i tërmetit të vitit 2019 tregoi se mungesa e sigurimit detyruës e detyroi qeverinë të përballojë koston e rindërtimit, e cila u vlerësua në rreth 7.5% të PBB-së. Kjo situatë është jo e qëndrueshme dhe rrit ndjeshëm riskun fiskal të vendit në të ardhmen.

Gjithashtu për shkak të rrezikut të lartë, kompanitë e sigurimeve shpesh:

- rrisin çmimet,
- kufizojnë mbulimin,
- ose hezitojnë të operojnë në këtë segment.

Nisma e propozuar krijon një bazë të fortë rregullatore dhe financiare, duke stabilizuar tregun dhe duke garantuar kujdes më të lartë ndaj konsumatorëve.

Në këtë kontekst, qeveria shqiptare po ndërmerr nismën ligjore për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, nëpërmjet së cilës synohet të krijohet një mekanizëm ligjor dhe financiar për mbulimin e humbjeve që mund të pësojnë pronarët e banesave nga dëmet e shkaktuara nga tërmetet, duke garantuar kompensimin e shpejtë dhe efikas të tyre.

Modeli i sigurimit të detyrueshëm është ndjekur nga praktikat e suksesshme ndërkombëtare, veçanërisht nga vendet si Turqia dhe Rumania, të cilat kanë arritur të reduktojnë ndjeshëm koston fiskale dhe ekonomike që shkaktojnë katastrofat natyrore.

Kjo nismë pritet të përmirësojë ndjeshëm sistemin e menaxhimit të riskut në Shqipëri, duke siguruar një mbrojtje më të mirë financiare për qytetarët, në rastin e situatave emergjente të shkaktuara nga tërmetet, duke reduktuar barrën fiskale mbi buxhetin e shtetit pas këtyre ngjarjeve katastrofike.

Gjithashtu kjo nisëm përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi kombëtar të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, duke kontribuar në mbrojtjen afatgjatë të pronës dhe mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat kryesore dhe efektet e synuara të projektligjit janë:

1. **Mbulimi humbjeve financiare** të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të drejtpërdrejta të ndodhura në pasurinë e siguruar, të shkaktuara nga tërmetet.
2. **Reduktimi i ndikimit fiskal dhe ekonomik në rastet e ngjarjeve të tërmeteve**, duke shmangur situatat e papërgatitura dhe të paplanifikuara për buxhetin e shtetit, për raste të tilla të fatkeqësive natyrore, ku aplikimi i skemës së sigurimit të propozuar do të ndihmojë në shpërndarjen e riskut dhe uljen e presionit mbi financat publike.
3. **Përsheptim i procesit të dëmshpërblimit** duke parashikuar që dëmshpërblimi të bëhet brenda një afati më të shpejtë nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit, duke shmangur vonesat në raste të tilla emergjente.
4. **Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ngjarjeve të tërmeteve**, duke synuar reagim më të shpejtë dhe efikas ndaj pasojave të shkaktuara për shkak të këtyre fatkeqësive natyrore;

5. **Moskrijimi i barrës financiare te shtresat në nevojë**, duke garantuar që primi i sigurimit për shtresat në nevojë të mbulohet nga buxheti i shtetit;
6. **Zhvillimi i kulturës së sigurimit në Shqipëri**, duke synuar përhapjen e sigurimeve si një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e riskut në shoqëri dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarët për marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë së tyre.
7. **Krijimi i një skeme të qëndrueshme sigurimi, nëpërmjet krijimit të Fondit Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet** si person juridik publik, i organizuar në formën e një shoqërie aksionare.
8. **Garantimi i kryerjes së risigurimit dhe pagesave të dëmeve** nga Fondi Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (status quo): nënkupton vijimin me ligjin aktual. Në legjislacionin aktual nuk ka të parashkuar një ligj për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet. Ky ligj përbën një risi dhe domosdoshmëri, për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

Opsioni 1 (jorregullator):- nënkupton marrjen e masave jorregullatore si kryerja e fushatave ndërgjegjësuese dhe rritja e kontrolleve. Ky opsion nuk është i përshtatshëm për t'u zbatuar, pasi problematikat e evidentuara nuk mund të trajtohen nëpërmjet këtyre masave, por kërkohet një rregullim ligjor.

Opsioni 2 (rregullator):- nënkupton ndryshimin e ligjit ekzistues. Duke qenë se në legjislacionin aktual nuk është i parashkuar një ligj për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, ky opsion nuk mund të aplikohet, pasi mungon ligji bazë ku mund të kryhen këto ndryshime.

Opsioni 3 (rregullator) i preferuar: – Miratimi i një ligji për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, është opsioni më i përshtatshëm për adresimin e problematikave dhe realizimin e objektivave të përmendur si më sipër. Nisur nga fakti, se Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore, kjo nismë përbën një domosdoshmëri në legjislacionin shqiptar për arsye se, nëpërmjet sigurimit të detyrueshëm të banesave, garantohet mbulimi humbjeve financiare të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të drejtpërdrejta të ndodhura në pasurinë e siguruar, të shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Ndikimet ekonomike:

- **Garantohet mbrojtje financiare për qytetarët**, pasi mbulohen humbjet financiare të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të drejtpërdrejta të ndodhura në pasurinë e siguar, të shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit.
- **Reduktimi i ndikimit fiskal dhe ekonomik në rastet e ngjarjeve të tërmeteve**, duke shmangur situatat e papërgatitura dhe të paplanifikuara për buxhetin e shtetit, për raste të tilla të fatkeqësive natyrore. Nëpërmjet kësaj nisme, shteti në rastin e këtyre fatkeqësive natyrore, arrin t'ju përgjigjet nevojave bazë të shoqërisë, duke reduktuar efektet e tyre, pasi sigurohet mbulimi humbjeve financiare për cdo të siguar, për dëmet e drejtpërdrejta të ndodhura në pasurinë e siguar.
- **Moskrijimi i barrës financiare te shtresat në nevojë**, duke garantuar që primi i sigurimit të mbulohet nga buxheti i shtetit;
- **Përsheptim i procesit të dëmshpërblimit** duke parashikuar që dëmshpërblimi të bëhet brenda një afati më të shpejtë nga dorëzimi i dokumentacionit, me qëllim shmangien e vonesave në këto raste emergjente. Në këtë mënyrë nisma e propozuar do të ndikojë që procesi i rikuperimit lidhur me dëmet e ndodhura nga ngjarjet e tërmetit, të mos zgjasë tepër në kohë.
- **Krijimi i një skeme të qëndrueshme sigurimi, nëpërmjet krijimit të Fondit Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet** si person juridik publik, i organizuar në formën e një shoqërie aksionare, i cili është përgjegjës për lidhjen e kontratave të sigurimit, administrimin e primeve të sigurimit të detyrueshëm, krijimin e përfitimeve nga investimi i të ardhurave nga kontratat e sigurimit, trajtimin dhe pagesën e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm.

Ndikimet sociale që pritet të sjellë kjo nismë:

- **Zhvillimi i kulturës së sigurimit në Shqipëri**, duke synuar përhapjen e sigurimeve si një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e riskut në shoqëri dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarët për marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë së tyre.
- **Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ngjarjeve të tërmeteve**, duke synuar reagim më të shpejtë dhe efikas ndaj pasojave të ndodhura për shkak të tërmeteve;
- **Përfshirje sociale dhe barazi në mbrojtje** duke garantuar mbrojtje edhe për shtresat në nevojë, ku për shtresat në nevojë primi i sigurimit do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 3- Miratimi i një ligji për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet është opsioni preferuar për arsye se:

- **Së pari:** Nisur nga fakti, se Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore, kjo nismë përbën një domosdoshmëri në legjislacionin shqiptar, në mënyrë që shteti t’i përgjigjet shoqërisë në rastin e pasojave të ndodhura nga ngjarjet e tërmetit.
- **Së dyti:** Kjo nismë përbën një risi në legjislacionin shqiptar me qëllim që të garantohet mbrojtje financiare për qytetarët, të cilët do të kompensohen financiarisht për dëmet e shkaktuara në banesat e tyre.
- **Së treti:** Kjo nismë që propozohet do të ndikojë në reduktimin e ndikimit fiskal dhe ekonomik në rastet e ngjarjeve të tërmeteve, ku aplikimi i skemës së sigurimit të propozuar do të ndihmojë në shpërndarjen e riskut dhe uljen e presionit mbi financat publike.
- **Së katërti:** Nisma është e domosdoshme me qëllim përsheptimin e procesit të dëmshpërblimit, duke shmangur vonesat në këto raste emergjente.
- **Së pesti:** Një tjetër qëllim i kësaj nisme është zhvillimi i kulturës së sigurimit në Shqipëri, duke synuar përhapjen e sigurimeve si një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e riskut në shoqëri dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarët për marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë së tyre.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Procesi i konsultimit filloi me publikimin në RENJK të njoftimit paraprak sipas legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik në periudhën 23.07.2025 deri në datë 20.08.2025.

Disa nga komentet e dërguara në RENJK janë si më poshtë vijon:

- Projektligji përkufizon banesat dhe seksionet e brendshme, por lë paqartësi për ndërtesat me përdorim të përzier ose për strukturat që janë vetëm pjesërisht rezidenciale. Këto raste mund të sjellin interpretime të ndryshme dhe mosmarrëveshje gjatë zbatimit. Po ashtu, përkufizimi i “ngjarjes së tërmetit” lidhet me magnitudën mbi 5.0, por nuk specifikohet procesi për njohjen dhe shpalljen zyrtare të saj nga autoritetet, duke krijuar hapësirë për kontestim.

Në shkronjën “g” të nenit 4 të projektligjit është dhënë përkufizimi se çfarë kuptojmë me ngjarje tërmeti, magnituda e tërmetit dhe detyrat e përgjegjësive të Autoritetit Kombëtar përgjegjës për tërmetet.

- Mbrojtja e të dhënave personale. Projektligji parashikon krijimin e një regjistri të sigurimit dhe shkëmbim të të dhënave ndërmjet institucioneve, por nuk referon në mënyrë të qartë përputhshmërinë me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Pa saktësime të tilla, ekziston rreziku i kontestimeve ligjore për privatësinë dhe të drejtat e qytetarëve.

Komenti merret parasysh. Të dhënat në regjistrin e sigurimeve do të administrohen në përputhje me ligjin 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- Zbatim fazor duke testuar efektet në zona urbane me risk të lartë.

Në pikën 2 të nenit 8 është parashikuar që metodologjia e përcaktimit të primit, termat, klasifikimi i banesave mbi bazë rreziku do të vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Marrëdhënia me sigurimin privat. Projektligji trajton sigurimin e detyrueshëm dhe atë vullnetar, por koordinimi mes tyre dhe renditja e pagesave nuk është i detajuar. Për të shmangur mbivendosje dhe kontestime, nevojiten rregulla të qarta mbi trajtimin e pretendimeve dhe të drejtën e subrogimit.

Kjo çështje është sqaruar në pikën 6 të nenit 14 të projektligjit. Sigurimit vullnetar është plotësues i detyrimit për sigurim i cili buron nga ligji.

- Vendosja e një modeli progresiv dhe të subvencionuar, për shtresat në nevojë dhe zonat me rrezik të ulët.

Pagesa e primit për shtresat në nevojë do të bëhet nga buxheti i shtetit.

- Në këtë nen mungon një ndarje sipas riskut, për shembull sipas zonës sizmike ose kategorisë së ndërtimit. Duhet të përfshihet një klasifikim i zonave me rrezik të lartë, duke vendosur politika çmimesh të diferencuara.

Në pikën 2 të nenit 8 është parashikuar që metodologjia e përcaktimit të primit, termat, klasifikimi i banesave mbi bazë rreziku do të vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Bashkëlidhur, edhe tabela me komentet e dërguara nga individët/grupet e interesit, në RENJK.

Lidhur me komentet e dërguara në RENJK, Ministria e Financave ka zhvilluar takime me grupet e interesit.

Projektligji dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetit të Konkurrencës, Institutit të Ndërtimit, Bankës Botërore në Shqipëri, Institutit të Gjeoshkencave dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Fondi Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet krijohet si person juridik publik, i organizuar në formën e një shoqërie aksionare, sipas këtij projektligji dhe të ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Autoriteti Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Fondit, është ministria përgjegjëse për financat.

1. Fondi është përgjegjës për:

- a) lidhjen e kontratave të sigurimit;
- b) administrimin e primeve të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
- c) krijimin e përfitimeve nga investimi i të ardhurave nga kontratat e sigurimit;
- d) risigurimin e përgjegjësive
- e) trajtimin dhe pagesën e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
- f) përcaktimin e primit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm.
- g) zbatimin e detyrave të përcaktuara në statut dhe aktet rregullatore në zbatim të këtij ligji.

2. Fondi siguron që në veprimtarinë e tij të mbështetet në një sistem elektronik informacioni sipas rregullave të miratuara nga Fondi, pas dhënies së mendimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili të paktën siguron:

- a) lidhjen e kontratave të sigurimit të detyrueshëm;
- b) regjistrimin e të dhënave të subjekteve, pagesave të primit, dëmet;
- c) monitorimin e vazhdueshëm të akumulimit të rrezikut të sigurimit nga tërmetet dhe vlerësimin e dëmeve të pritshme përmes zhvillimit dhe përdorimit të modeleve të rrezikut të sigurimit nga tërmetet dhe modelit të rrezikut të zhvilluar për Republikën e Shqipërisë.

Organet e Fondit janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Këshilli Mbikëqyrës;
3. Administratori.

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare, marketingut, planin e risigurimit, si dhe programet edukative dhe promovuese;
- b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- c) miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Administratorit si dhe të punonjësve;
- d) miratimin e statutit të Fondit për Tërmetet dhe ndryshimin e tij;
- e) miratimin e strategjisë së zhvillimit;
- f) miraton paraprakisht dokumentet mbi politikat e investimeve;
- g) miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës;
- h) aktet dhe dokumentat me natyrë financiare dhe marrëveshjet me të tretët;
- i) çështje të tjera të iniciuara nga Këshilli Mbikëqyrës ose të parashikuara në këtë ligj, në statutin e shoqërisë në zbatim të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

2. Këshilli Mbikëqyrës ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:

- a) miraton paraprakisht strategjitë e zhvillimit, planin e risigurimit, dokumentet mbi politikat e investimeve dhe ato operacionale, vendimet për planet e marketingut dhe të tretët, si dhe programet edukative dhe promovuese;
- b) miraton rregulloren për trajtimin e pagesës dhe ankesës për dëmshpërblim;
- c) miraton rregulloren për krijimin, dhe alokimet e përdorimin e fondit të rezervës;
- d) miraton rregulloren mbi strukturën organizative, përshkrimin e punës, ruajtjen e konfidencialitet, si dhe organizimin dhe funksionimin e Fondit për Tërmetet;
- e) miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit;
- f) miraton paraprakisht pasqyrat financiare të Fondit;
- g) miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Fondit për vitin e mëparshëm, dhe e paraqet tek ministri përgjegjës për financat;
- h) ushtron çdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë ligj, statutin e shoqërisë, akteve rregullatore në zbatim të këtij ligji.

3. Administratori i Fondit organizon dhe administron veprimtarinë e përditshme të institucionit.

Administratori i Fondit për Tërmetet ka këto kompetenca:

- a) përfaqëson Fondin me të tretët;
- b) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës;
- c) përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e vendimeve të miratuara;
- d) i propozon Këshillit Mbikëqyrës çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Fondit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij;
- e) nxjerr urdhra në përmbushje të kompetencave të tij me karakter ekzekutiv.
- f) emëron dhe shkarkon punonjësit e Fondit;
- g) përmbush detyra dhe përgjegjësi të tjera, në përputhje me aktet rregullatore të Fondit dhe statutin.

Fondi është përgjegjës për regjistrin dhe garanton që regjistri është i plotë, gjithëpërfshirës dhe i përditësuar në çdo kohë.

Regjistri i Sigurimit të Detyrueshëm është një bazë të dhënash sipas ligjit për bazën e të dhënave shtetërore, i cili krijohet me qëllime grumbullimin dhe ruajtjen e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme për ofrimin e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet.

Regjistri i sigurimit të detyrueshëm për tërmetet:

- a) mbledh dhe ruan të dhënat e pronave të siguruara;
- b) krijojnë një bazë të dhënash elektronike të nevojshme me qëllim ruajtjen e informacioneve të marra nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
- c) mbledh dhe ruan të dhënat që lidhen me kontratat e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet.

Pasqyrat financiare vjetore të Fondit auditohen nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionim e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe çertifkohen nga auditues të jashtëm, që miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës, në përputhje me

standardet dhe kriteret e parashikuara në rregulloren përkatëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Veprimtaria e Fondit auditohet nga auditues të brendshëm, të cilët miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë të këtij projektligji dhe përvoja është e nevojshme në zbatim të legjislacionit për sigurimin dhe risigurimin në Republikën e Shqipërisë, mbikëqyr Fondin, në drejtim të unifikimit të rregulloreve dhe standardizimit të akteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij me këtë projektligj dhe ligjet e fushës, të transparencës ndaj publikut, të zbatueshmërisë së termave dhe kushteve të kontratave që lidhen me të siguarit, të mbikëqyrjes dhe garantimit të mbrojtjes së konsumatorit në lidhje me kontratat e sigurimit të detyrueshëm të banesave, si dhe të monitorimit të zbatueshmërisë së politikave të investimeve kur konstaton se nuk janë në përputhje me aktet rregullatore të vendosura apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.

Fondi i raporton të paktën 2 (dy) herë në vit ministrit përgjegjës për financat dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas modelit tip të raportimit të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, të miratuar paraprakisht nga kjo e fundit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Shqipëria çenohet nga një sërë fatkeqësish natyrore. Rreziqet kryesore që prekin Shqipërinë janë tërmetet, përmytjet, zjarret pyjore dhe rrëshqitjet e tokës. Rreziqet e tjera përfshijnë stuhi dëbore, thatësi, ekstreme të temperaturës, epidemi, ortekë, rreziqe teknologjike (p.sh., shpërthime të digave) dhe stuhi të erës. Baza e të dhënave ndërkombëtare të Fatkeqësisë (EM-DAT) tregon se, gjatë viteve 1979-2019, tërmetet përbënin rreth 15%. Rreziqet më të mëdha në Shqipëri janë tërmetet e forta dhe përmytjet e lumenjve në shkallë të gjerë. Cenueshmëria e popullsisë shqiptare ndaj fatkeqësive të shkallëve të mëdha dhe të vogla shoqërohet edhe nga një sërë faktorësh mjedisorë të ndikuar nga njeriu, nga shpyllëzimi i shpejtë dhe deri te ndotja e mjedisit. Për më tepër, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës mbi këto risqe mbetet i ulët.

Tërmeti përkufizohet si lëkundje intensive e sipërfaqes së Tokës e shkaktuar nga lëvizjet në shtresat më të jashtme të Tokës. Si i tillë ai klasifikohet si rrezik gjeologjik ose gjeofizik që do të thotë se është rezultat i proceseve të brendshme të Tokës. Tërmetet mund të shkaktojnë rrëshqitje të tokës, zjarre dhe cunami, të cilat më pas çojnë në nivele shumë më të larta dëmtimesh dhe humbesh. Shqipëria karakterizohet nga veprimtaria e mikrotërmeteve intensive ($1.0 < M \leq 3.0$), e tërmeteve me madhësi të vogël ($3.0 < M \leq 5.0$) dhe mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe vetëm rrallë nga ngjarje me tërmete të mëdha ($M > 7.0$). Shqipëria është një vend që ka përjetuar ngjarje të rëndësishme dhe të rënda sizmike, me 10 tërmete me magnitudë ≥ 6.0 Ms për periudhën 1919 deri më sot, brenda territorit të vendit. Në Shqipëri ka tri zona sizmogenike gjatësore (joniane-adriatike, Shkodër-Mat-Bilisht dhe Drini [Peshkopi-Korçë]) dhe tri tërthore (Shkodër-Pejë, Lushnjë-Elbasan-Dibër dhe Vlorë-Tepelenë).

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) është institucioni këshillimor teknik dhe shkencor i shtetit që ushtron aktivitete në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka një bazë të dhënash të fortë në lidhje me veprimtarinë e rreziqeve të ndryshme natyrore, përfshirë hartat e rreziqeve gjeologjike. Departamenti i Sizmologjisë së IGJEO (UPT) është e vetmja njësi operative dhe shkencore në Shqipëri që mbulon monitorimin e vazhdueshëm të sizmitetit në vend.

Qendra Kombëtare e Monitorimit të aktivitetit sizmik ka detyrë parësore monitorimin e pandërprerë 24 orë në 24, të aktivitetit sizmologjik të ndodhur brenda territorit të Shqipërisë dhe rreth saj. Në kuadër të emergjencave civile, kjo qendër mundëson informim thuajse në kohë reale të strukturave përkatëse operacionale mbi situata të emergjencave sizmike. Për përmbushjen e kësaj detyre parësore me një rëndësi të madhe për vendin, kjo qendër disponon dhe operon Rrjetin Sizmologjik Shqiptar, pjesë e të cilit janë: - rrjeti i lëkundjeve të dobëta sizmike ose rrjeti sizmografik (AWMN); - rrjeti i lëkundjeve të forta ose akselerografik (ASMN); - rrjeti gjeodezik në ndihmë të studimit të karakteristikave sizmotektonike të Shqipërisë i përbërë nga disa stacione permanente regjistrimi (GPS).

Aktualisht në legjislacionin shqiptar nuk është parashikuar një ligj për sigurimin e banesave nga tërmetet. Sigurimi është pjesë e paketave vullnetare të ofruara nga kompanitë private të sigurimeve. Përgjatë viteve evidentohet një numër shumë i ulët i banesave të siguruara nga tërmetet dhe kjo situatë rëndoi edhe më tepër pasojat e ndodhura me tërmetin e datës 26.11.2019.

Për më tepër, shumë kontrata sigurimi ishin të lidhura vetëm për efekt të kredive hipotekore, pra mbulonin shumën e kredisë, jo vlerën reale të banesës. Gjithashtu përgjatë viteve konstatohet se ndërgjegjësimi për sigurimin e banesave nga tërmetet është i ulët dhe për më tepër shumë qytetar nuk e konsiderojnë sigurimin si një prioritet, përveç rasteve kur kërkohej nga bankat.

Nisma e propozuar është ndërmarrë duke u mbështetur në përvojat e të vendeve të tjera si: Turqia, Rumania. Referuar ligjit që aplikohet në këto shtete është kryer edhe një tabelë krahasimore si vijon:

Vendi	Skema ligjore	Institucioni përgjegjës	Primi mesatar
Turqia	Sigurim i detyrueshëm që nga viti 2000 (TCIP – Turkish Catastrophe Insurance Pool)	Fondi shtetëror TCIP	Rreth 40–60 € në vit për banesë mesatare
Rumania	Sigurim i detyrueshëm që nga viti 2009 (PAID – Pool-ul de Asigurare Împotriva Dezastrelor Naturale)	Konsorcium privat me mbështetje shtetërore	Rreth 10–20 € në vit

Lidhur me këtë nismën, propozohet që metodologjia e përcaktimit të primit, termat, klasifikimi i banesave mbi bazë rreziku, të llogaritet me metodologji aktuariale, bazuar në modelin e rrezikut nga tërmetet të

zhvilluar për Shqipërinë, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit përgjegjës për financat, pas dhënies së pëlqimit nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare

Referuar praktikave të vendeve të mësipërme, ndërgjegjësimi të ulët të qytetarëve dhe pasojave të rënda që shkaktojnë ngjarjet të tilla si tërmetet, është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e detyrueshme e banesave nga tërmetet.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi kryesor lidhet me faktin se Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore, si dhe në legjislacionin aktual mungon një ligj për trajtimin e kësaj problematike. Katër rreziqet kryesore që prekin vendin tonë janë: tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e dheut. Raporti i Rrezikut Botëror 2021, i cili llogarit Indeks të Rrezikut të Fatkeqësive për 181 vende, bazuar në kapacitetet përballuese, e rendit Shqipërinë të parën në Evropë dhe në vend të 61, në rang botëror.

Duke filluar nga viti 1900, Shqipëria është goditur nga dymbëdhjetë tërmete me magnitudë mbi 6 ballë. Në nëntor 2019, një tërmet shkatërrues me magnitudë 6.4 ballë, goditi Shqipërinë, duke prekur mbi 200,000 njerëz në 11 bashki dhe duke shkaktuar një ndikim të konsiderueshëm ekonomik të vlerësuar në 7.5 për qind të produktit të brendshëm bruto. Pjesa më e madhe e dëmit u përqendrua në banesat rezidenciale me 18% të totalit të njësive të banimit të prekura. Pas tërmetit të vitit 2019, qeveria duhej të ndërhynte dhe të siguronte fonde për rindërtimin e pronave të shkatërruara të banimit.

Në përgjithësi, faktorët kryesorë të riskut për rrezikun sizmik në Shqipëri përfshijnë ndërtimet e paligjshme, të cilat shpesh përfshijnë mosrespektimin e kriterëve të sigurisë së vetë ndërtimit dhe vendosjen e ndërtesave në zona me risk të lartë sizmik siç është ish-këneta e Durrësit, ku një tërmet shkakton shembjen e ndërtesave.

Përveç kësaj, ekziston një nivel i ulët i sigurimit të pasurive të paluajtshme dhe aftësisë së një pjese të popullsisë (veçanërisht rurale) për t'u rimëkëmbur nga pasojat e tërmeteve.

Raporte dhe dokumente të shumta evidentojnë nivelin e lartë të risqeve që kërcënojnë vendin, ekspozimin dhe cenueshmërinë e lartë. Si rezultat i ekspozimit të lartë, fatkeqësitë po prekin rrugën e zhvillimit të Shqipërisë.

Një histori e gjatë tërmetesh në Shqipëri jo vetëm që ka nisur zhvendosjen e popullsisë nga zonat e goditura nga një tërmet, por ka ndikuar ndjeshëm edhe në trashëgiminë kulturore të Shqipërisë.

Për shembull, tërmeti i vitit 1851 preku qytetin historik të Beratit në një mënyrë që tipologjia e ndërtesave dy-trekatëshe me murature guri ndryshoi në ndërtesa me murature të përzier, ku për lehtësi dhe shpejtësi, katet e dyta u ndërtuan si një strukturë druri. Aktualisht mbi 2220 pasuri kulturore dhe mbi 210 qendra historike, zona të mbrojtura dhe zona arkeologjike të listuara në regjistrin kombëtar të trashëgimisë kulturore konsiderohen të prekshme nga tërmetet për shkak të një sërë faktorësh si vjetërsia e ndërtesave, kushtet e dobëta teknike të ndërtimit dhe projektimit dhe mungesa e mirëmbajtjes. Duke qenë se dëmtimi i

aseteve kulturore rezultojn jo vetëm në humbje të koleksioneve muzeale, fondeve arkeologjike dhe dokumenteve të rëndësishme arkivore, por edhe në humbje të kujtesës kolektive të komunitetit, mbrojtja e trashëgimisë është vendosur edhe si një nga shtyllat kryesore në Ligjin 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Rreziqet natyrore dhe gjeografike

Shqipëria ka një ekspozim të natyrshëm të lartë ndaj fatkeqësive, i cili nuk mund të eliminohet por vetëm të menaxhohet:

1. Tërmetet

- Ndodhin shpesh për shkak të pozicionimit gjeologjik të vendit.
- 12 tërmete me magnitudë mbi 6 ballë që nga viti 1900.
- Ngjarja e vitit 2019 tregoi potencialin e lartë shkatërrues.

2. Zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e dheut

- Zjarret masive shkaktojnë humbje të mbulesës bimore dhe rrisin erozionin.
- Terrenet malore janë të prirura ndaj rrëshqitjeve, sidomos pas reshjeve të dendura.

B. Mungesa e një kuadri ligjor të posaçëm

Nuk ekziston një ligj që të rregullojë skemën e sigurimit të detyrueshëm për banesat nga fatkeqësitë natyrore. Kjo mungesë përbën një problem sistematik me pasoja të gjera sociale, ekonomike, fiskale dhe institucionale. Vendit i mungon një mekanizëm kombëtar i menaxhimit financiar të riskut, i cili është i domosdoshëm për një shtet me ekspozim të lartë ndaj rreziqeve natyrore.

Mungesa e një ligji që e bën sigurimin të detyrueshëm, lë shumicën e familjeve të ekspozuara financiarisht.

- Vetëm një pjesë shumë e vogël e banesave në Shqipëri është aktualisht e siguruar në mënyrë vullnetare.
- Familjet me të ardhura të ulëta, të mesme dhe veçanërisht ato në zonat më të rrezikuara, shpesh nuk kanë mundësi ekonomike të sigurojnë vetë pronën.
- Në rast tërmeti, qytetarët mbeten pa asnjë mekanizëm kompensimi të paracaktuar, duke humbur kursimet e jetës dhe pasurinë bazë të banimit.

Ky fakt shton pasigurinë sociale, cenon mirëqenien e familjeve dhe e bën rimëkëmbjen individuale shumë të ngadaltë.

2. Ndikimi mbi buxhetin e shtetit

Në mungesë të një skeme të detyrueshme sigurimi, çdo ngjarje e madhe natyrore shkakton:

- presion të menjëhershëm fiskal mbi qeverinë;
- nevojë për mobilizim të fondeve për rindërtim;

- rishpërndarje të buxhetit publik me ndikim ndaj prioriteteve të tjera (shëndetësi, arsim, investime publike).

Shembulli i tërmetit të vitit 2019 tregoi se mungesa e sigurimit detyruës e detyroi qeverinë të përballojë koston e rindërtimit, e cila u vlerësua në rreth 7.5% të PBB-së. Kjo situatë është jo e qëndrueshme dhe rrit ndjeshëm riskun fiskal të vendit në të ardhmen.

3. Nevoja për një mekanizëm të qëndrueshëm për menaxhimin e riskut

Shqipëria është një ndër vendet më të ekspozuara ndaj tërmeteve në Evropë. Pa një ligj për sigurimin e detyrueshëm:

- Nuk ekziston një arkitekturë kombëtare për shpërndarjen e riskut.
- Nuk krijohet një fond financiar i mjaftueshëm për përballimin e humbjeve masive.
- Nuk ka një sistem të paracaktuar për vlerësimin, likuidimin dhe kompensimin e dëmeve.

Në raste emergjencash, reagimi bëhet i fragmentuar dhe i varur nga kapacitetet momentale të institucioneve dhe buxhetit të shtetit.

4. Rimëkëmbja pas fatkeqësive

Për shkak të mungesës së sigurimit të detyrueshëm:

- procesi i kompensimit kërkon kohë;
- rindërtimi varet nga fondet publike, donacionet ose kontributet ndërkombëtare;
- familjet, sidomos në zonat e varfra, mund të mbeten për periudha të gjata pa banesa të përshtatshme;

5. Ndikimi në tregun e sigurimeve private

Mungesa e një ligji e bën tregun e sigurimeve private:

- të paqëndrueshëm financiarisht në rast të dëmeve të mëdha.

Për shkak të rrezikut të lartë, kompanitë e sigurimeve shpesh:

- rrisin çmimet,
- kufizojnë mbulimin,
- ose hezitojnë të operojnë në këtë segment.

Një ligj i posaçëm krijon një bazë të fortë rregullatore dhe financiare, duke stabilizuar tregun dhe duke garantuar kujdes më të mirë ndaj konsumatorëve.

6. Cënim i sigurisë urbane dhe planifikimit afatgjatë

Mungesa e një skeme të detyrueshme sigurimi krijon:

- mungesë të motivimit për përdorim të materialeve cilësore në ndërtim;
- prirje për të fshehur rreziqet mjedisore;
- rritje të ndërtimeve jo të sigurta;
- presion më të madh mbi infrastrukturën publike pas fatkeqësive.

Një skemë sigurimi, e rregulluar me ligj, vepron gjithashtu si instrument parandalues, duke incentivuar ndërtuesit dhe pronarët të marrin masa sigurie.

7. Ndikimet te qytetarët

Pa një ligj të qartë:

- qytetarët nuk e dinë çfarë mbulohet, çfarë nuk mbulohet dhe si funksionon procesi i kompensimit;
- nuk ekziston një standard i unifikuar për trajtimin e dëmeve;
- procesi i kompensimit kërkon kohë.

C. Faktorët socio-ekonomikë

1. Shumë qytetarë nuk kanë mundësi financiare për sigurime private
Duke qenë se aktualisht sigurimi është vullnetar, për familjet me të ardhura të ulëta, sigurimi nuk konsiderohet prioritet.
2. Ndërtesa të vjetra dhe të pambrojtura
Një pjesë e madhe e stokut të banesave është e ndërtuar para standarteve ndërkombëtare të ndërtimit.
3. Informim i ulët mbi menaxhimin e riskut
Mungesa e kulturës së sigurimit rrit pabarazitë në mbrojtjen nga fatkeqësitë.

Grupet e prekura nga problematikat janë:

1. Qytetarët dhe familjet

- Përballen me rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe pronën.
- Humbja e banesës sjell pasoja të rënda ekonomike dhe sociale.
- Familjet e varfra dhe ato në zonat rurale janë më të ekspozuara ndaj rrezikut.
- Mungesa e sigurimit shkakton pasiguri dhe varësi nga ndihma e shtetit.

2. Shteti dhe financat publike

- Peshat e rindërtimit pas katastrofave bie drejtpërdrejt mbi buxhetin.
- Krijon presion mbi financat publike dhe devijim të fondeve nga prioritetet e tjera.
- Procesin e rindërtimit përfshin kosto administrative, logjistike dhe sociale.

3. Bashkitë dhe njësitë vendore

- Duhet të reagojnë menjëherë në menaxhimin e emergjencave.
- Përballen me mungesë fondesh dhe kapacitetesh si për parandalimin, ashtu edhe për rehabilitimin e zonave të prekura.

4. Sektori privat i sigurimeve

- Aktualisht ka treg të kufizuar për sigurimet e banesave.

- Duhet të rrisin kapacitetet aktuariale, teknike dhe financiare për të përballuar modelet e reja të riskut.

5. Ekonomia dhe bizneset e lidhura

- Aktivitetet ekonomike pësojnë dëme nga ndërprerjet dhe tërmetet.
- Investimet mund të ngadalësohen për shkak të perceptimit të rrezikut.
- Kostot e dëmeve ndikojnë në rritjen e çmimeve dhe në uljen e produktivitetit.

Analiza tregon qartë se problemi ka natyrë komplekse rregullatore dhe jorregullatore, me shkaqe të kombinuara natyrore, institucionale dhe socio-ekonomike.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për arsye se:

Së pari: Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore dhe trajtimi i kësaj problematike nëpërmjet një rregullimi të plotë ligjor është i nevojshëm.

Së dyti: Në legjislacionin aktual nuk ka një ligj të parashikuar për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet.

Së treti: Nëpërmjet kësaj nisme, shteti në rastin e fatkeqësive natyrore, si tërmetet arrin t'ju përgjigjet nevojave bazë të shoqërisë, duke reduktuar efektet e kësaj fatkeqësie natyrore.

Konkretisht nëpërmjet kësaj nisme garantohet mbrojtje financiare për qytetarët të cilët do të kompensohen financiarisht për dëmet e shkaktuara nga tërmetet në banesat e tyre, dhe reduktim i ndikimit fiskal dhe ekonomik në rastet e ngjarjeve të tërmeteve.

Së katërti: Kjo nisëm është e nevojshme edhe me qëllim përshpejtimin e procesit të dëmshpërblimit, duke shmangur vonesat në këto raste emergjente. Në këtë mënyrë nisma e propozuar do të ndikojë që procesi i rikuperimit lidhur me dëmet e ndodhura nga ngjarjet e tërmetit, të mos zgjasë tepër në kohë.

Së pesti: Kjo nisëm përbën një domosdoshmëri edhe për:

- **Zhvillimin e kulturës së sigurimit në Shqipëri,** duke synuar përhapjen e sigurimeve si një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e riskut në shoqëri dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarët për marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë së tyre.
- **Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ngjarjeve të tërmeteve,** duke synuar reagim më të shpejtë dhe efikas ndaj pasojave të ndodhura për shkak të tërmeteve;
- **Përfshirjen sociale dhe barazi në mbrojtje** duke garantuar mbrojtje edhe për shtresat në nevojë, ku për shtresat në nevojë primi i sigurimit do të mbulohet nga buxheti i shtetit

Në këto kushte, ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të plotësuar kuadrin rregullator në këtë fushë, duke garantuar mbulimin e humbjeve financiare të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të ndodhura në pasurinë e siguar, të shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit.

Në këtë kontekst, qeveria shqiptare po ndërmerr nismën ligjore për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, në mënyrë që shteti t'i përgjigjet shoqërisë në rastin e pasojave të ndodhura për shkak të këtyre fatkeqësive natyrore. Konkretisht nëpërmjet kësaj nisme synohet të krijohet një mekanizëm ligjor dhe financiar për mbulimin e humbjeve që mund të pësojnë pronarët e banesave nga dëmet e shkaktuara nga tërmetet, duke garantuar kompensimin e shpejtë dhe efikas të tyre.

Modeli i sigurimit të detyrueshëm është frymëzuar nga praktikat e suksesshme ndërkombëtare, veçanërisht nga vendet si Turqia dhe Rumania, të cilat kanë arritur të reduktojnë ndjeshëm koston fiskale dhe ekonomike që shkaktjnë katastrofat natyrore.

Kjo nismë pritet të përmirësojë ndjeshëm sistemin e menaxhimit të riskut në Shqipëri, duke siguruar një mbrojtje më të mirë financiare për qytetarët dhe duke reduktuar barrën fiskale mbi buxhetin e shtetit pas ngjarjeve katastrofike.

Gjithashtu kjo nisëm përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi kombëtar të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë, duke kontribuar në mbrojtjen afatgjatë të pronës dhe mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

Në këtë mënyrë garantohet mbrojtje financiare për qytetarët dhe reduktim i ndikimit fiskal dhe ekonomik në rastet e ngjarjeve të tërmeteve, duke shmangur situatat e papërgatitura dhe të paplanifikuara për buxhetin e shtetit, për raste të tilla të fatkeqësive natyrore, ku aplikimi i skemës së sigurimit të propozuar do të ndikojë në shpërndarjen e riskut dhe uljen e presionit mbi financat publike.

Për më tepër kjo ndërhyrje vjen në përshtatje edhe me Programin e Qeverisë 2021-2025, ku përcaktohet si një nga shtyllat kryesore edhe: *Rimëkëmbja e ekonomisë nga tërmeti dhe pandemia*.

Programi i Qeverisë 2021–2025 vendos një theks të veçantë te rimëkëmbja ekonomike dhe sociale pas tërmetit të vitit 2019, një ngjarje që shkaktoi dëme të mëdha në mijëra banesa dhe solli një kosto të konsiderueshme financiare për shtetin. Përvoja e asaj periudhe tregoi qartë se Shqipëria ka nevojë për mekanizma më të fortë të parandalimit dhe përbalimit të fatkeqësive natyrore, për të rritur reziliencën e qytetarëve dhe për të reduktuar presionin mbi buxhetin e shtetit.

Në këtë kuadër, sigurimi i detyrueshëm i banesave nga tërmetet përfaqëson një instrument kyç të politikave të rimëkëmbjes. Ky mekanizëm synon të krijojë një burim të qëndrueshëm financiar që mbulon dëmet e ardhshme të shkaktuara nga tërmetet. Kjo zgjidhje e re jo vetëm që ndihmon qytetarët të rimëkëmben më shpejt pas një ngjarjeje të rëndë, por gjithashtu shmang devijimin e fondeve publike nga investimet në zhvillim drejt rindërtimit, një problem i evidentuar qartë pas tërmetit të 2019-s.

Për më tepër, nisma kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e qytetarëve dhe forcimin e sigurisë sociale, duke garantuar kompensim të shpejtë, të drejtë dhe të pavarur nga kapacitetet e tyre financiare. Duke mbrojtur pasurinë më të rëndësishme të familjeve shqiptare—banesën—kjo skemë ndihmon në parandalimin e rënies së familjeve në varfëri pas fatkeqësive dhe mbështet objektivin e qeverisë për forcimin e shtresës së mesme.

Në të njëjtën linjë me objektivat e modernizimit të sistemeve të menaxhimit të riskut, nisma për sigurimin e detyrueshëm të banesave harmonizohet me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Ajo përfaqëson një mekanizëm afatgjatë që garanton stabilitet, siguri dhe përgatitje më të mirë për përballimin e rreziqeve natyrore, duke qenë plotësisht në përputhje me angazhimet e Programit të Qeverisë 2021–2025.

Çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Nëpërmjet nismës së propozuar për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, synohet të garantohet mbulimi i humbjeve financiare të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të ndodhura në pasurinë e siguruar, të shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit sipas kriterëve të përcaktuara në projektligj.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, shteti shqiptar ka ndërmarrë një sërë masash për rimëkëmbjen si:

- krijimin e programeve të rindërtimit,
- mobilizimin e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare,
- ndihma financiare për familjet e prekura,
- si dhe projekte infrastrukturore për rikonstrukcionin e banesave, shkollave dhe objekteve publike.

Masat kryesore të marra nga shteti:

- **Fondet e rindërtimit**
- Qeveria shpalli një program kombëtar rindërtimi, të financuar nga buxheti i shtetit dhe donatorët ndërkombëtarë.
- U krijua një fond i posaçëm për rimëkëmbjen, ku u përfshinë ndihma nga BE, Banka Botërore, BERZH dhe organizata të tjera ndërkombëtare.
- **Ndihma për familjet e prekura**
- U dhanë bonus qiraje për mijëra familje deri në ndërtimin e banesave të reja.
- Rindërtimi i banesave dhe pallateve të dëmtuara.
- U rikonstruktuan pallate të dëmtuara dhe u ndërtuan shtëpi individuale për familjet në fshatra.
- Rindërtimi i shkollave, qendrave shëndetësore dhe objekteve të kultit të dëmtuara nga tërmeti.
- Investime në rrugë dhe infrastrukturë urbane për të përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e jetesës.

Ristrukturimi i fundit i sistemit kombëtar të menaxhimit të fatkeqësive ishte një hap në drejtim të një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të fatkeqësive, megjithatë vijohet për ndërgjegjësimin, zhvillimin e kapaciteteve, zhvillimin dhe përforcimin e infrastrukturës, komunikimin dhe bashkëpunimin ndërsektorial, si dhe gatishmërinë për përgjigje dhe rimëkëmbje. Investimi në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë mund të rezultojë jo vetëm në zvogëlimin e humbjeve dhe dëmeve, por në qëndrueshmëri ekonomike dhe mundësi të reja. Periudha e zhvillimit dhe ristrukturimit të shpejtë të vendit është koha e

përsosur për të integruar zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në zhvillimin e politikave të qeverisë në të gjitha nivelet, për të vendosur investime të ndërgjegjshme ndaj riskut dhe për të siguruar që zhvillimet e reja të jenë të zgjuara dhe të qëndrueshme.

- Nisma për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet nuk është vetëm një masë që lidhet me objektivat e Programit të Qeverisë 2021–2025, por përputhet plotësisht edhe me drejtimet strategjike të **Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive**. Kjo strategji thekson domosdoshmërinë e krijimit të mekanizmave që reduktojnë ekspozimin dhe çënueshmërinë e qytetarëve ndaj fatkeqësive natyrore, si dhe forcimin e instrumenteve financiarë që garantojnë një reagim efektiv dhe të qëndrueshëm ndaj ngjarjeve katastrofike.
- Në dokumentin strategjik nënvizohet rëndësia e zhvillimit të kapaciteteve për menaxhimin e riskut, përfshirë modernizimin e sistemeve të parandalimit, përgatitjes dhe rimëkëmbjes. Sigurimi i detyrueshëm i banesave është një ndër instrumentet më të rëndësishme të këtij kuadri, pasi adreson drejtpërdrejt një nga boshllëqet kryesore të evidentuara: mungesën e një mekanizmi financiar të qëndrueshëm që mbulon dëmet në sektorin e banesave, sektor i cili historikisht ka pësuar dëmet më të mëdha gjatë tërmeteve.
- Strategjia thekson gjithashtu nevojën për të ulur barrën fiskale dhe sociale që sjellin fatkeqësitë natyrore. Përvoja e tërmetit të vitit 2019 tregoi se, në mungesë të një skeme sigurimi, shteti detyrohet të përballojë kostot e rindërtimit dhe kompensimit, duke devijuar burime të mëdha financiare nga politikat zhvillimore. Nisma e propozuar e redukton ndjeshëm këtë barrë, duke krijuar një mekanizëm financiar parandalues që shpërndan riskun dhe rrit qëndrueshmërinë e shoqërisë në tërësi.
- Një tjetër element kyç i Strategjisë Kombëtare është forcimi i reziliencës së komuniteteve dhe mbrojtja e shtresave vulnerabël. Sigurimi i detyrueshëm për banesat kontribuon drejtpërdrejt në këtë qëllim, sepse garanton që familjet – pavarësisht të ardhurave apo vendbanimit – të kenë një nivel të sigurt mbrojtjeje financiare në rast fatkeqësish. Kjo ndihmon në uljen e rrezikut social, parandalon rënien në varfëri pas humbjeve të mëdha dhe përmirëson aftësinë e komuniteteve për t'u rimëkëmbur me shpejtësi.
- Gjithashtu, Strategjia Kombëtare nxit adoptimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, veçanërisht të modeleve të vendeve që përballen me rreziqe të ngjashme natyrore. Nisma për sigurimin e detyrueshëm, e frymëzuar nga përvoja e Turqisë, Rumanisë dhe vendeve të BE-së, është në përputhje të plotë me këtë qasje dhe përbën një hap të qartë drejt integritimit të standardeve bashkëkohore në sistemin kombëtar të menaxhimit të riskut.
- Në këtë kuadër, sigurimi i detyrueshëm i banesave nga tërmetet përbën jo vetëm një domosdoshmëri ligjore dhe sociale, por edhe një mekanizëm strategjik që realizon në praktikë objektivat themelore të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive, duke forcuar reziliencën, ulur riskun dhe rritur sigurinë ekonomike dhe sociale të qytetarëve shqiptarë

Me qëllim rimëkëmbjen nga tërmetet e ndodhura në vitin 2019, janë ndërmarrë aktet si vijon:

Akt normativ nr. 6, datë 30.11.2019 “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019” ku parashikohej dhurimi apartamenteve, të ndodhura në Njësinë Administrative nr. 1, Tiranë, për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019. Njësitë e

vetëqeverisjes vendore dhurojnë në favor të familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019 edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Akt normativ Nr. 7, datë 30.11.2019 “Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar sipas të cilit pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes si pasojë e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, përfitojnë trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social, ndërsa personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë deri në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social. Pensionistët, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë vetëm trajtimin në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social. Trajtimi i veçantë financiar caktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.

Akt normative Nr. 8, datë 7.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, sipas të cilit familjeve, të cilave u është dëmtuar banesa si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, dhe janë evakuar nga banesat e tyre për shkak se u rrezikohet jeta dhe shëndeti, u subvencionohet në masë të plotë pagesa e qirasë së banesës, në vlerën mesatare të tregut të lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe/ose njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Akt normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Ky akt ka për qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Akt Normativ nr. 37, datë 24.12.2020 “Për një ndryshim në aktin normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019” ku përcaktohet se subvencionimi i pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, do të zgjasë deri në momentin që familjeve u rindërtohen apo rikonstruktohen banesat, të cilat, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore janë:

1. **Mbulimi humbjeve financiare** të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të drejtpërdrejta të ndodhura në pasurinë e siguruar, të shkaktuara nga tërmetet;
2. **Reduktimi i ndikimit fiskal dhe ekonomik** në rastet e ngjarjeve të tërmeteve, duke shmangur situatat e papërgatitura dhe të paplanifikuara për buxhetin e shtetit, për raste të tilla të fatkeqësive natyrore, ku aplikimi i skemës së sigurimit të propozuar do të ndihmojë në shpërndarjen e riskut dhe uljen e presionit mbi financat publike.
3. **Përshejtim i procesit të dëmshpërblimit** duke parashikuar që dëmshpërblimi të bëhet brenda një afati më të shpejtë nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit, duke shmangur vonesat në raste të tilla emergjente.
4. **Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ngjarjeve të tërmeteve**, duke synuar reagim më të shpejtë dhe efikas ndaj pasojave të ndodhura për shkak të tërmeteve;
5. **Moskrijimi i barrës financiare te shtresat në nevojë**, duke garantuar që primi i sigurimit të mbulohet nga buxheti i shtetit;
6. **Zhvillimi i kulturës së sigurimit në Shqipëri**, duke synuar përhapjen e sigurimeve si një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e riskut në shoqëri dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarët për marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë së tyre;
7. **Krijimi i një skeme të qëndrueshme sigurimi, nëpërmjet krijimit të Fondit Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet** si person juridik publik, i organizuar në formën e një shoqërie aksionare.
8. **Garantimi i kryerjes së risigurimit dhe pagesave të dëmeve** nga Fondi Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

1. *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
2. *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
3. *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0 (status quo): Ky opsion nënkupton vijimin me ligjin aktual, por duke qenë se në legjislacionin aktual, nuk është i parashikuar një ligj për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, ky opsion nuk mund të aplikohet. Sigurimet aktuale janë vullnetare dhe niveli i tyre është minimal. Si rrjedhojë, ky opsion nuk mund të aplikohet në mënyrë efektive, pasi nuk ofron asnjë mekanizëm ligjor apo financiar për të adresuar problematikën e evidentuar.

Avantazhet

- Mungesë kostoje administrative për hartimin dhe zbatimin e një ligji të ri.
- Vazhdimësi institucionale, pa nevojë për ndryshime të strukturave apo procedurave ekzistuese.

Disavantazhet

- Qytetarët mbeten të pambrojtur financiarisht.
- Buxheti i shtetit mbetet i ekspozuar ndaj kostove të mëdha të rindërtimit pas fatkeqësive.

- Menaxhim reaktiv, jo parandalues i rreziqeve natyrore.
- Nuk përmirësohet mbrojtja e pronës dhe siguria e qytetarëve, duke ndikuar në një model të paqëndrueshëm menaxhimi të riskut.

Opsioni 1 (jorregullator):- Opsioni 1 parashikon ndërmarrjen e masave jorregullatore, si fushata ndërgjegjësimi për rreziqet natyrore, nxitja e sigurimeve vullnetare, përmirësimi i kontrollit të zbatimit të rregullave në ndërtim, ose investime të vogla administrative. Megjithatë, këto masa nuk e adresojnë boshllëkun kryesor ligjor: mungesën e një mekanizmi financiar të detyrueshëm për sigurimin e banesave.

Avantazhet

- Mund të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për rrezikun dhe nevojën për sigurim.
- Kosto më të ulëta në krahasim me hartimin e një ligji të ri.
- Mund të përmirësojë kulturën e riskut dhe të rrisë kontrollet në sektorin e ndërtimit.

Disavantazhet

- Nuk garanton mbulim financiar pas fatkeqësive, pasi sigurimi mbetet vullnetar.
- Ka efekt të kufizuar, pasi familjet me të ardhura të ulëta nuk kanë mundësi për sigurime private.
- Nuk redukton barrën fiskale të shtetit, i cili prapë do të duhet të financojë rindërtimin.
- Nuk krijon sistemin kombëtar të menaxhimit financiar të riskut, që është i nevojshëm për vendet me rrezik të lartë si Shqipëria.

Opsioni 2 (rregullator):– Ky opsion do të nënkuptonte ndryshimin e një ligji aktual për të vendosur dispozita mbi sigurimin e detyrueshëm të banesave. Megjithatë, aktualisht **nuk ekziston një akt bazë** që të rregullojë sigurimin e banesave nga fatkeqësitë natyrore, ndaj nuk ka objekt ligjor që mund të ndryshohet. Për këtë arsye, opsioni është i pazbatueshëm dhe nuk garanton krijimin e një sistemi të plotë dhe funksional.

Avantazhet

- Në teori, do të shmangte hartimin e një ligji krejtësisht të ri.
- Do të mund të thjeshtonte procedurën legjislative, nëse do të ekzistonte një ligj bazë.

Disavantazhet

- I pazbatueshëm në praktikë, për shkak të mungesës së një ligji ekzistues për t'u ndryshuar.
- Mund të çonte në një zgjidhje të pjesshme, jo të qëndrueshme dhe me boshllëqe rregullatore.
- Nuk krijon një arkitekturë të plotë ligjore, e cila është e domosdoshme për një skemë sigurimi detyrues.
- Rrezikon të prodhojë një kuadër të fragmentuar, të paqartë dhe jo funksional për qytetarët dhe kompanitë e sigurimeve.

Opsioni 3 (rregullator) i preferuar: – Miratimi i një ligji për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet, është opsioni më i përshtatshëm për adresimin e problematikave të evidentuara dhe realizimin e

objektivave të përmendur si më sipër. Nisur nga fakti, se Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore, kjo nismë përbën një domosdoshmëri në legjislacionin shqiptar, pasi kontribuon në reduktimin e çënueshmërisë së shoqërisë, ndaj fatkeqësive natyrore, konkretisht tërmetit. Në këtë mënyrë, nëpërmjet sigurimit të detyrueshëm të banesave, garantohet mbulimi humbjeve financiare të pësuar nga i siguruari, për shkak të dëmeve të ndodhura në pasurinë e siguar, të shkaktuara nga ngjarjet e tërmetit.

Modeli mbështetet në praktikat e suksesshme të vendeve si Turqia dhe Rumania, të cilat kanë reduktuar në mënyrë të ndjeshme kostot e fatkeqësive dhe kohën e rikuperimit.

Avantazhet

- Siguron mbrojtje financiare të garantuar për qytetarët në rast tërmeti.
- Shpërndan riskun në mënyrë të qëndrueshme.
- Redukton në mënyrë të konsiderueshme koston fiskale pas fatkeqësive, duke ruajtur stabilitetin buxhetor.
- Rrit qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të familjeve dhe komuniteteve.
- Krijon një sistem kombëtar të parashikueshëm për mbulimin e dëmeve.
- Përmirëson kulturën e sigurisë dhe menaxhimit të riskut në nivel shoqëror.
- Mundëson përfitime afatgjata për zhvillimin urban, ndërtimin e sigurt dhe investimet.

Disavantazhet

- Mund të krijojë kosto administrative fillestare, si ngritja e strukturave të reja, IT, auditimi dhe monitorimi.
- Kërkon koordinim të ngushtë ndërinstytucional dhe ngritjen e kompetencave teknike.

Nga krahasimi i opsioneve, rezulton se:

- Opsioni 0 dhe Opsioni 1 nuk adresojnë problemin dhe nuk ofrojnë zgjidhje për mbrojtjen financiare të qytetarëve.
- Opsioni 2 është i pazbatueshëm për shkak të mungesës së një ligji bazë.
- Opsioni 3 është i vetmi që krijon një zgjidhje të plotë, të qëndrueshme dhe të mbështetur në praktika ndërkombëtare, duke garantuar mbrojtjen e banesave dhe reduktimin e barrës fiskale.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

→ Identifikoni grupet e prekura.

→ Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

→ Për ndikimet e drejtpërdrejta:

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
- *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*

→ *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

→ *Diskutoni kufizimin e analizës:*

- *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

→ *Përmbli dhni vlerësimin e opsioneve:*

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Ndikimet e projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet:

Familjet/Qytetarët

A. Ndikimet e drejtpërdrejta (cilësore)

1. Detyrimi për pagesën e primit të sigurimit

Qytetarët do të kenë detyrimin ligjor të paguajnë një prim vjetor sigurimi për banesën e tyre.

2. Siguri më e madhe financiare

Projektligji krijon një garanci ligjore që në rast dëmi familjet do të marrin dëmshpërblim. Kjo rrit stabilitetin ekonomik të familjeve dhe ul pasiguritë për menaxhimin e rreziqeve.

3. Rritje e kërkesës për dokumente të identifikimit të pronës

Për të lidhur kontratat e sigurimit dhe për të përfituar nga dëmshpërblimi, familjet do të duhet të kenë dokumentacion të rregullt për pronësinë, planimetrinë dhe vlerën e pasurisë. Kjo nxit formalizimin.

4. Përfitime më të shpejta në rast dëmi

Projektligji prezanton afate të qarta për likuidimin e dëmeve, çka rrit transparencën dhe shpejtësinë e procesit të dëmshpërblimit.

B. Ndikimet e drejtpërdrejta (sasiore / monetare)

1. Kostoja vjetore për primin e sigurimit

Ndikimi kryesor monetar është pagesa e primit vjetor nga të gjithë qytetarët, e llogaritshme si:

Numri i banesave × primi vjetor mesatar

(nuk ka shifra zyrtare — varet nga aktet nënligjore të ardhshme).

2. Kosto më e ulët personale në rast dëmi

Edhe pse qytetarët paguajnë një prim vjetor, ata shmangin rrezikun për të paguar vetë mijëra euro në rast fatkeqësie, çka është ulje e ekspozimit financiar.

3. Ndikim në buxhetin familjar

Për familjet me të ardhura të ulëta, projektligji parashikon që primi i tyre mbulohet nga buxheti i shtetit, që ul efektin negativ financiar.

4. Mundësi uljeje të kostove në treg

Një skemë e qëndrueshme dhe e detyrueshme rrit bazën e të siguruarve, krijon shpërndarje më të gjerë të riskut.

C. Ndikimet indirekte mbi qytetarët

1. Rritje e ndërgjegjësimit për menaxhimin e riskut

Detyrimi për sigurim nxit kulturën e sigurimeve dhe sjellje më të kujdesshme ndaj rrezikut.

2. Nxitje për dokumentacion të rregullt pronësie

Familjet që ende nuk e kanë dokumentacionin e plotë do të synojnë ta rregullojnë atë për të përfituar nga skema.

3. Formalizim më i madh i tregut të banesave

Regjistrimi i saktë i banesave dhe vlerave të tyre ndikon pozitivisht në transparencën e sektorit.

4. Stabilitet afatgjatë në komunitete

Me një skemë të garantuar sigurimi, qytetarët nuk përballen më me pasiguri financiare që i detyrojnë të largohen nga zonat e prekura. Kjo rrit qëndrueshmërinë sociale.

D. Ndikimet pozitive dhe negative të balancuara

Pozitive:

- Siguri financiare në rast dëmi.
- Pagesë e shpejtë e dëmshpërblimeve.
- Mbështetje e drejtpërdrejtë për familjet vulnerabël.
- Rritje e transparencës dhe drejtësisë në trajtimin e dëmeve.
- Formalizim i tregut të pasurive të paluajtshme.

Negative / sfida:

- Detyrimi financiar vjetor për çdo familje.
- Nevoja për dokumentacion të plotë të pronës.
- Mundësi rezistence sociale ndaj modelit të detyrueshëm.

Ndikimet e nismës mbi Shtetin

A. Ndikimet e drejtpërdrejta (cilësore)

1. Reduktim i barrës fiskale në rast fatkeqësish

Projektligji krijon një mekanizëm financiar të qëndrueshëm për kompensimin e dëmeve nga tërmetet. Kjo do të thotë që shteti nuk do të duhet të përdorë fonde emergjente të buxhetit për të mbuluar të gjitha humbjet e qytetarëve.

2. Forcim i menaxhimit të rrezikut

Shteti do të ketë mundësi të organizojë dhe menaxhojë më mirë fondet dhe instrumentet për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive. Fondi Kombëtar i Sigurimit do të bëhet një instrument i centralizuar, duke përmirësuar kapacitetin institucional.

3. Reagim më i shpejtë dhe efikas ndaj emergjencave

Me sigurimin e detyrueshëm, shteti nuk duhet të merret me shpërndarjen e fondeve emergjente për çdo rast dëmi, duke u fokusuar në koordinimin e ndihmës dhe shërbimeve të emergjencës.

B. Ndikimet e drejtpërdrejta (sasiore / monetare)

- 1. Kosto e reduktuar e ndërhyrjeve buxhetore emergjente.** Projektligji zvogëlon shpenzimet e paplanifikuara për rindërtim, kompensime dhe strehim të përkohshëm.
- 2. Përfitime financiare nga fondi i sigurimeve.** Fondet e mbledhura nga primet përdoren për dëmshpërblim dhe risigurim, duke ulur ekspozimin e drejtpërdrejtë të buxhetit të shtetit ndaj ngjarjeve të papritura.

C. Ndikimet indirekte

- 1. Përmirësim i kapaciteteve institucionale.** Projektligji kërkon krijimin e mekanizmave të menaxhimit dhe monitorimit të Fondit Kombëtar, duke rritur efikasitetin administrativ të shtetit.
- 2. Stabilitet social dhe ekonomik.** Duke siguruar kompensim të shpejtë dhe të drejtë, shteti zvogëlon tensionet sociale pas këtyre katastrofave natyrore.
- 3. Integrimi me standardet ndërkombëtare.** Skema është në përputhje me praktikën e vendeve me rrezik të lartë sizmik dhe rekomandimet e BE-së, duke rritur besueshmërinë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në këtë fazë është e pamundur kryerja e një analize të saktë monetare për grupet e prekura, për disa arsye objektive si më poshtë:

1. Familjet / Qytetarët

- **Primi i sigurimit nuk është përcaktuar ende.** Shuma që çdo familje do të paguajë nuk është e vendosur, pasi aktet nënligjore dhe metodologjia e llogaritjes së primave nuk janë miratuar. Pa këtë, nuk mund të llogaritet kosto totale për qytetarët.
- **Numri i banesave të përfshira nuk është përfundimisht identifikuar.** Ka pasiguri për saktësinë e numrit të njërive që do të përfshihen në skemë, sidomos për banesat me pronësi të paqarta ose të papërfunduara.

2. Shteti / Buxheti Publik

- **Shuma totale e fondeve që do të alokohen nga shteti është e paqartë në këtë fazë.** Pa përcaktimin e primave, numrit të banesave subvencionuese dhe nivelit të riskut, nuk mund të llogaritet ndikimi i saktë në buxhetin publik.
- **Efekti i shpërndarjes së riskut nuk është matshëm.** Reduktimi i kostove emergjente për buxhetin do të varet nga shkalla reale e fatkeqësive natyrore dhe dëmet që ndodhin, të cilat janë të paparashikueshme.
- **Kostoja e administrimit të Fondit Kombëtar nuk është përcaktuar.** Shpenzimet për stafin, IT, risigurimin dhe operacionet e Fondit janë ende të paplota, duke e bërë të pamundur llogaritjen e ndikimit neto financiar.

Pra, arsyet objektive që e bëjnë të pamundur kryerjen e analizës sasiore në terma monetarë të ndikimit financiar janë:

1. Mungesa e shifrave zyrtare për primet e sigurimit dhe mbulimin e banesave
2. Pasiguria mbi numrin dhe llojin e banesave që do të përfshihen në skemë
3. Variabiliteti i fatkeqësive natyrore dhe intensiteti i dëmeve
4. Kostoja e administrimit dhe risigurimit të Fondit Kombëtar nuk mund të përcaktohet në këtë fazë;
5. Subvencionimi i familjeve vulnerabël dhe efektet mbi buxhetin publik nuk janë përcaktuar

Pa miratimin e aktit nënligjor dhe të dhënat operationale të Fondit Kombëtar, çdo vlerësim monetar do të ishte spekulativ dhe jo i besueshëm.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

1. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
2. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 3- Miratimi i një ligji për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet është opsioni preferuar për arsye se:

- Së pari: Nisur nga fakti, se Shqipëria është një vend i prirur dhe ekspozuar ndaj fatkeqësive natyrore, kjo nismë përbën një domosdoshmëri në legjislacionin shqiptar, në mënyrë që shteti t'i përgjigjet shoqërisë në rastin e pasojave të ndodhura nga ngjarjet e tërmetit.

- Së dyti: Kjo nisëm përbën një risi në legjislacionin shqiptar me qëllim që të garantohet mbrojtje financiare për qytetarët, të cilët do të kompensohen financiarisht për dëmet e shkaktuara nga tërmetet në banesat e tyre.
- Së treti: Kjo nisëm do të ndikojë në reduktimin e ndikimit fiskal dhe ekonomik në rastet e ngjarjeve të tërmeteve, ku aplikimi i skemës së sigurimit të propozuar do të ndihmojë në shpërndarjen e riskut dhe uljen e presionit mbi financat publike.
- Së katërti: Nisma e propozuar është e domosdoshme me qëllim përshpejtimin e procesit të dëmshpërblimit, duke shmangur vonesat në këto raste emergjente.
- Së pesti: Nisma propozohet me qëllim për të zhvilluar kulturën e sigurimit në Shqipëri, duke synuar përhapjen e sigurimeve si një mjet i domosdoshëm për menaxhimin e riskut në shoqëri dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarët për marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë së tyre.

Lidhur me analizë e kostove dhe përfitimeve që parashikohet të sjellë ky projektligj, kemi vlerësuar si metodë më të përshtatshme për të analizuar opsionet, metodën e analizës me shumë kriterë. Kuantifikimi i kostove dhe përfitimeve nga ndryshimet e parashikuara në këtë projektligj në vlerë monetare rezulton i pjesshëm dhe i vështirë për t'u bërë. Si rezultat kemi identifikuar 5 kriterë me rëndësi për të vlerësuar opsionet të cilat janë të renditura së bashku me peshën respektive në tabelën e mëposhtme:

<u>Kriteret</u>	<u>Pesha</u>	<u>Opsioni 0</u>	<u>Opsioni 1</u>	<u>Opsioni 2</u>	<u>Opsioni 3</u>
Reduktimi i ndikimit fiskal dhe ekonomik në buxhetin e shtetit në rastet e ngjarjeve të tërmeteve;	<u>4</u>	<u>0 (0)</u>	<u>0 (0)</u>	<u>4 (16)</u>	<u>4 (16)</u>
Efektiviteti i përshpejtimin të procesit të dëmshpërblimit për palët	<u>4</u>	<u>0 (0)</u>	<u>0 (0)</u>	<u>0 (0)</u>	<u>5 (20)</u>
Krijimi i mekanizmave për mbështetjen e shtresave në nevojë përmes mbulimit të kostos së primit nga buxheti i shtetit	<u>4</u>	<u>0 (0)</u>	<u>0 (0)</u>	<u>4 (16)</u>	<u>4 (16)</u>
Efektiviteti në trajtimin në kohë, me efience dhe drejtësi të kategorive specifike duke thjeshtëzuar procedurat e përfitimeve nga ligji	<u>3</u>	<u>1 (3)</u>	<u>2 (6)</u>	<u>3 (9)</u>	<u>3 (9)</u>
Kosto-efektiviteti	<u>5</u>	<u>1 (5)</u>	<u>2 (10)</u>	<u>3 (15)</u>	<u>5 (25)</u>
Pikët		<u>8</u>	<u>16</u>	<u>56</u>	<u>86</u>

Sikurse rezulton nga analiza opsioni i preferuar rezulton opsioni 3 i cila ka dhe numrin më të lartë të pikëve me 86 krahasuar me opsionet e tjera

Si rezultat, vlerësojmë që opsioni më i përshtatshëm dhe nga pikëpamja financiare do të jetë opsioni i hartimi të një ligji për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet.

Çështje të zbatimit

- o *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- o *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- o *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Fondi Kombëtar për Sigurimin e Detyrueshëm nga Tërmetet krijohet si person juridik publik, i organizuar në formën e një shoqërie aksionare, sipas këtij projektligji dhe të ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Autoriteti Publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Fondit, është ministria përgjegjëse për financat.

Fondi është përgjegjës për:

- a. lidhjen e kontratave të sigurimit;
- b. administrimin e primeve të sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
- c. krijimin e përfitimeve nga investimi i të ardhurave nga kontratat e sigurimit;
- d. risigurimin e përgjegjësive;
- e. trajtimin dhe pagesën e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm nga tërmetet;
- f. përcaktimin e primit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm.
- g. zbatimin e detyrave të përcaktuara në statut dhe aktet rregullatore në zbatim të këtij ligji.

Fondi siguron që në veprimtarinë e tij të mbështetet në një sistem elektronik informacioni sipas rregullave të miratuara nga Fondi, pas dhënies së mendimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili të paktën siguron:

- a) lidhjen e kontratave të sigurimit të detyrueshëm;
- b) regjistrimin e të dhënave të subjekteve, pagesave të primit, dëmet;
- c) monitorimin e vazhdueshëm të akumulimit të rrezikut të sigurimit nga tërmetet dhe vlerësimin e dëmeve të pritshme përmes zhvillimit dhe përdorimit të modeleve të rrezikut të sigurimit nga tërmetet dhe modelit të rrezikut të zhvilluar për Republikën e Shqipërisë.

Organet e Fondit janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Këshilli Mbikëqyrës;
3. Administratori.

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare, marketingut, planin e risigurimit, si dhe programet edukative dhe promovuese;
- b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- c) miraton pagën, shpërblimet si dhe trajtimet financiare të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës,

Administratorit si dhe të punonjësve;

- d) miratimin e statutit të Fondit për Tërmetet dhe ndryshimin e tij;
- e) miratimin e strategjisë së zhvillimit;
- f) miraton paraprakisht dokumentet mbi politikat e investimeve;
- g) miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës;
- h) aktet dhe dokumentat me natyrë financiare dhe marrëveshjet me të tretët;
- i) çështje të tjera të iniciuara nga Këshilli Mbikëqyrës ose të parashikuara në këtë projektligj, statutin e shoqërisë në zbatim të ligjit për tregtarët dhe shoqërite tregtare.

2. Këshilli Mbikëqyrës ushtron në mënyrë të pavarur këto kompetenca:

- a) miraton paraprakisht strategjitë e zhvillimit, planin e risigurimit, dokumentet mbi politikat e investimeve dhe ato operacionale, vendimet për planet e marketingut dhe të tretët, si dhe programet edukative dhe promovuese;
- b) miraton rregulloren për trajtimin e pagesës dhe ankesës për dëmshpërblim;
- c) miraton rregulloren për krijimin, dhe alokimet e përdorimin e fondit të rezervës;
- d) miraton rregulloren mbi strukturën organizative, përshkrimin e punës, ruajtjen e konfidencialitet, si dhe organizimin dhe funksionimin e Fondit për Tërmetet;
- e) miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit;
- f) miraton paraprakisht pasqyrat financiare të Fondit;
- g) miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Fondit për vitin e mëparshëm, dhe e paraqet tek ministri përgjegjës për financat;
- h) ushtron çdo detyrë tjetër të parashikuar në këtë ligj, statutin e shoqërisë, akteve rregullatore në zbatim të këtij ligji.

3. Administratori i Fondit organizon dhe administron veprimtarinë e përditshme të institucionit.

Administratori i Fondit ka këto kompetenca:

- a) përfaqëson Fondin me të tretët;
- b) organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e administratës;
- c) përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e vendimeve të miratuara;
- d) i propozon Këshillit Mbikëqyrës çështjet që duhen përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të Fondit dhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij;
- e) nxjerr urdhra në përmbushje të kompetencave të tij me karakter ekzekutiv.
- f) emëron dhe shkarkon punonjësit e Fondit;
- g) përmbush detyra dhe përgjegjësi të tjera, në përputhje me aktet rregullatore të Fondit dhe statutin.

Pengesat e mundshme që mund të lindin janë:

- Mosndërgjegjësimi i qytetarëve;

- Mospagesa nga qytetarët që duhet të kryhet me qëllim sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- o *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- o *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Pasqyrat financiare vjetore të Fondit auditohen nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionim e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe çertifikohen nga auditues të jashtëm, që miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës, në përputhje me standardet dhe kriteret e parashikuara në rregulloren përkatëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Veprimtaria e Fondit auditohet nga auditues të brendshëm, të cilët miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë të këtij projektligji dhe përsa është e nevojshme në zbatim të legjislacionit për sigurimin dhe risigurimin në Republikën e Shqipërisë, mbikëqyr Fondin, në drejtim të unifikimit të rregulloreve dhe standardizimit të akteve rregullatore gjatë veprimtarisë së tij me këtë projektligj dhe ligjet e fushës, të transparencës ndaj publikut, të zbatueshmërisë së termave dhe kushteve të kontratave që lidhen me të siguruarit, të mbikëqyrjes dhe garantimit të mbrojtjes së konsumatorit në lidhje me kontratat e sigurimit të detyrueshëm të banesave, si dhe të monitorimit të zbatueshmërisë së politikave të investimeve kur konstaton se nuk janë në përputhje me aktet rregullatore të vendosura apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.

Fondi i raporton të paktën 2 (dy) herë në vit ministrit përgjegjës për financat dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas modelit tip të raportimit të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, të miratuar paraprakisht nga kjo e fundit.

Kriteret dhe treguesit kryesorë për matjen e progresit përfshijnë: performancën financiare të fondeve, efikasitetin e administrimit dhe auditimit, mbikëqyrjen dhe zbatueshmërinë e rregulloreve, mbrojtjen e konsumatorit, raportimin publik dhe transparencën, dhe arritjen e objektivave strategjike të mbulimit dhe reduktimit të barrës fiskale.

1. Kriteret dhe treguesit financiarë

1. Performanca e fondeve të mbledhura nga primet e sigurimit

- o Tregues: Shuma totale e primave të mbledhura brenda vitit.
- o Tregues: Përqindja e mbledhjes së primave ndaj planit të vitit.

2. Shpenzimet për dëmshpërblim

- o Tregues: Shuma totale e dëmeve të paguara ndaj të siguruarve.
- o Tregues: Afati mesatar i pagesës së dëmshpërblimeve nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit.

3. Marrja e risigurimit dhe menaxhimi i riskut

- o Tregues: Përqindja e kontratave të risigurimit të lidhura mbi portofolin total.
- o Tregues: Shuma e kompensimeve të paguara nga risigurimi për ngjarje të mëdha.

4. Performanca e investimeve të Fondit

- Tregues: Norma e kthimit mbi investimet e kontratave të sigurimit.

2. Kriteret dhe treguesit administrativë

1. Auditimi dhe kontrolli i brendshëm

- Tregues: Numri i raporteve të auditimit të brendshëm të përgatitura dhe miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
- Tregues: Numri i gjetjeve të auditimit dhe niveli i adresimit të tyre brenda afateve të përcaktuara.

2. Auditimi i jashtëm

- Tregues: Raportet e auditimit të jashtëm të përgatitura dhe çertifikuara sipas standardeve ndërkombëtare.
- Tregues: Numri i rekomandimeve nga auditimi i jashtëm dhe implementimi i tyre.

3. Raportimi ndaj autoriteteve

- Tregues: Numri i raporteve vjetore dhe periodike të dorëzuara ndaj Ministrisë të Financave dhe AMF.
- Tregues: Përputhshmëria e raporteve me modelin e miratuar nga AMF dhe standardet ndërkombëtare.

3. Kriteret dhe treguesit të mbikëqyrjes dhe transparencës

1. Zbatimi i rregulloreve dhe akteve rregullatore

- Tregues: Përqindja e aktit të Fondit dhe kontratave të sigurimit që janë në përputhje me rregulloret.

2. Mbrojtja e konsumatorit

- Tregues: Numri i ankesave të qytetarëve të trajtuara brenda afateve ligjore.
- Tregues: Koha mesatare e zgjidhjes së ankesave të konsumatorit.

3. Transparenca dhe raportimi publik

- Tregues: Disponueshmëria e raporteve publike mbi aktivitetin e Fondit.
- Tregues: Saktësia dhe përputhshmëria e informacionit të publikuar me auditimin e brendshëm dhe atë të jashtëm.

4. Kriteret për progresin strategjik

1. Rritja e mbulimit të banesave nga sigurimi detyrueshëm

- Tregues: Përqindja e banesave të mbuluara nga skema krahasuar me totalin e banesave të vendit.

2. Reduktimi i barrës fiskale në rast fatkeqësish

- Tregues: Përqindja e dëmeve të mbuluara nga fondi i sigurimit në krahasim me ndihmat emergjente nga buxheti i shtetit.

3. Efikasiteti i mekanizmit të shpërndarjes së riskut

- Tregues: Numri i rasteve të kompensimit të kryera pa vonesa, koha mesatare e pagesës, dhe niveli i shpenzimeve administrative për çdo rast.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në 000/ lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Viti	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total –										

Vlera aktuale e kostos në total	
---------------------------------	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në 000/ lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			

MINISTRI

PETRIT MALAJ